

VENDIM
Nr.835, datë 3.12.2004

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR EMERGJENCAT CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 8 e 9 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ministrinë dhe institucionet të paraqesin në Këshillin e Ministrave, brenda muajit janar 2005, programet e punës për realizimin e detyrave të përcaktuara në matricën e masave parësore për emergjencat civile në Shqipëri, e cila është pjesë e planit kombëtar për emergjencat civile.
 3. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet të cilat kanë funksione dhe detyra specifike në planin kombëtar për emergjencat civile, për zbatimin e këtij plani.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano